



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1, Shkodër, ëeb: www.bashkiashkoder.gov.al, e-mail: info@bashkiashkoder.gov.al, Tel: +35522400150

PROCES VERBAL PËR KËSHILLIM ME PUBLIKUN

PËR

**“DRAFTIN E PROJEKT PLANIT BUXHETOR AFATMESËM 2023-2025 TË
BASHKISË SHKODËR”.**

Konsultim publik: Banorët e Rajonit nr. 2

Data: 17.10.2022

Ora: 13.00

Vendi: *Salla e Këshillit Bashkiak Shkodër.*

Numri i pjesëmarrësve : *Numri i pjesëmarrësve 20, nga të cilat 3 gra dhe vajza.*

Titulli i Projekt-aktit që konsultohet: *Për draft projekt planin buxhetor afatmesëm 2023-2025 të Bashkisë Shkodër*

Pjesëmarrës: Drejtues dhe specialistë të administratës së Bashkisë Shkodër dhe banorë (Bashkangjitur listë prezenca).

Takimi bashkë-drejtohet nga Zv/Kryetari i bashkisë dhe Kryetarja e Këshillit Bashkiak të cilët bënë një prezantim të shkurtër në lidhje me:

- ✦ Projekt-aktin e propozuar
- ✦ Shpjegoi qëllimin e konsultimit publik
- ✦ Shtroi pyetjet konkrete për pjesëmarrësit
- ✦ Dha informacion për mënyren e dhënies së rekomandimeve.
- ✦ Ju dha fjalën pjesëmarrësve

Pjesëmarrësit që morën fjalën, diskutuan dhe dhanë rekomandimet përkatëse në lidhje me çështjen që konsultohet janë si vijon :

Hapja konsultimit nga Zv/Kryetari i Bashkisë, fjala përshëndetëse dhe prezantimi i pjesëmarrësve pjesë e stafit të Bashkisë Shkodër në takim.

1. Arsimi baze parashkollor i Mesem dhe i Pergjithshem.

Andi Halluni, Këshilltar këshilli bashkiak – Fillimisht shoh që pjesëmarrja është e ulët në dëgjesë, si nga këshilltarët por edhe drejtues të shkollave, banorë etj.

1. Kemi diskutuar që vjet për problematikën tek kopshti **Tom Alimhilli**, rruga është shumë e ngushtë dhe ka nevojë për sinjalistikën përkatëse. Ka parkim të dyfishtë, shumë trafik dhe problematike për në mëngjes. Gjishtashtu duhen spostuar koshat e mbeturinave që janë pranë çerdhes.
2. **Shkolla Xheladin Fishta** – ka tre vite që e kërkojmë si investime sa i përket sistemimit të ujrave të zeza sepse vijon të jetë me grope septike. Shkolla ka edhe nevojë për shtesë të ambjenteve sepse ka një rritje të nr. të nxënësve
3. **Shkolla Skenderbeg** – është ngritur si problem qe vjet dhe aty është mbyllur palestra ku fëmijët e lagjes kanë ushtruar aktivitetet sportive në këtë ambient. Por që dy vite drejtoresha e shkollës nuk lejon shfrytëzimin e kësaj palestere për aktivitete sportive nga fëmijët e zonës.

Zv. kryetari - Bashkia Shkodër do të marrë një iniciative për hapjen e të gjitha palestrave dhe ambjenteve sportive që janë në shkolla për të bërë të mundur përdorimin nga ana e fëmijëve të lagjes së këtyre ambjenteve. Sa i përket shkollës Xheladin Fishta do të diskutojmë me drejtorinë e Ujsjellesit. Edhe në lidhje me kazanët pranë çerdhes do të shqyrtojmë problematiken që shtroni.

1- Menaxhimi i mbetjeve

Si është situata me koshat, a ka kontenier të mjaftueshëm në zonë, a duhet të shpeshtojmë frekuencën e pastrimit?

Elson Celiku – Sa i përket mbetjeve kemi propozuar që vjet për rrugën Hysen Lacaj, ku biznese dhe fasoneri shkarkojnë mbeturinat e tyre dhe duhet të ndahen nga koshat e banorëve. Janë rrobaqepësi, supermarkete dhe të tjera biznese të mëdha. Na është thënë që herën e kaluar për marrjen e masave por akoma nuk ka një zgjidhje.

Rruga Levizja e Postribës, pranë Merkatës, koshat janë gjatë gjithë kohës të mbushur dhe akoma nuk është marrë masë për këto problematika që janë parashtruar që një vit.

Andi Halluni - Pranë supermarket Xhedis në fund të Rusit, ka pafund mbeturina që depozitohen në pikën e grumbullimit të mbetjeve tek Rr. Hysen Lacaj. Propozoj që të vendosen kazana të dedikuara për këto biznese.

Gjithashtu sa i përket fshirjes së rrugëve, duhet të shtohet vemëndja për sa i përket zbatimit të detyrës së tyre për pastrim dhe fshirje të rrugës.

Zv. kryetari – tek rruga Hysen Lacaj ka një mbingarkesë sa i përket mbetjeve të fasonerive dhe jemi duke gjobitur këto biznese. Ato janë edhe mbetje që nuk pranohen nga ana e landfillit dhe ne kemi konstatuar këtë shkelje nga ana e këtyre bizneseve për të cilët do të reagojmë sërish me anë

të gjobave. Tek rruga Levizja e Postribës do të shtojmë pikë grumbullimi dhe gjithashtu kemi rritur edhe frekuencën e pastrimit.

Sa i përket supermarketeve jemi duke takuar të gjithë supermarketet për sa i përket sensibilizimit të tyre për menaxhimin e mbetjeve, sidomos për kutitë e kartonit, për të cilët do të bëjmë një diferencim të posaçëm.

Jona Leqejza, këshilltare bashkia Shkodër – në buxhetin e vitit të kaluar sipas një shkrese të derguar nga Ministria e Mjedisit e cila vendosi edhe disa kritere sa i takon normave të pastrimit të mbetjeve nga fasonerit dhe supermarketet. Dhe në buxhetin e 2022 ka qenë e parashikuar vendosja e konteniereve të veçantë pranë supermarketeve. A mendohet të zbatohet ky propozim në buxhet ?

A mendohet që të rritet tarifa/pagesa për këto biznese (pra supermarketet) dhe a do ti diferencojmë sipas madhësisë së tyre?

E njëjta gjë është edhe me fasoneritë ku duhet ti rritet tarifa sipas volumit të punës së tyre ose të gjehet një formë bashkëpunimi ku të ofrohet shërbim shtesë kundrejt pagesës.

Zv. kryetari – për fasonerit ne e kishim gjetur një rrugë bashkëpunimi edhe me landfillin por tanimë landfilli nuk është duke i pranuar më. Me sa kemi dijeni fasonerit kanë kontrata për menaxhimin e mbetjeve të tyre privatisht por këto kontrata janë formale dhe nuk i zbatojnë duke shkarkuar mbetjet në pikat tona të grumbullimit ndërkohë që landfilli nuk i pranon më.

Për supermarketet do të bëjmë një takim të përbashkët me to për të bërë minimalisht krijimin e koshave të veçantë për kartonat, të dedikuara për supermarketet.

Elson Celiku – ndoshta duhet që edhe kazanat dhe pikat e grumbullimit të mos jenë të gjitha në një vend sepse duke qënë mbi 6 kazana në një pikë kjo krijon edhe mundësinë nga ana e fasonerit që të shkarkojnë të gjitha në një vend.

Andi Halluni – me sa di fasonerite gjobiten por sërisht vazhdojnë të tresin mbetjet në pikat tona të grumbullimit, prandaj mendoj që duhet të shtohet masa e gjobës si dhe të vendosen kazanat brenda ambjenteteve të tyre pa u perzier me pikat e grumbullimit të banorëve.

2- Shërbimet ne komunitet

Gjelberim dhe ndricim rrugor

Alban Dani, përfaqesues i Shkodra Tennis - Kompleksi jonë i tenisit është kompleksi më i madhi në rajon dhe përveç aktivitetit sportiv privat ne i kemi hapur ambjentet tona edhe për shkollat. Gjatë aktivitetit tonë ne japim impakt edhe në turizëm dhe zhvillim. Vitin tjetër ne kemi të miratuar mbi 10 turne ndërkombëtare me një numër të madh pjesëmarrësish dhe normalisht edhe turistësh.

Kërkesa jonë është të behet ndricimi tek rruga e Tenisit (*Rruga e Hurmave*). *Rrugë rreth 500 – 600 metra.*

1. Kërkojmë gjithashtu nga bashkia mbështetje me baze materiale.
2. Mbështetje për pagesën e arbitrave ndërkombëtarë.

Ky është një aset për bashkinë tashmë dhe mendojmë që puna jonë dhe mbështëtja nga ana e bashkisë do të ketë rol pozitiv.

Zv. kryetari – do të jetë prioritet edhe për ne pjesa e ndricimit aty. Sa i përket mbështëtjes me buxhet nga ana e jonë për honorare dhe mbështetje materiale do të diskutojmë edhe më gjërë për gjetjen e mbështëtjes financiare.

Banor, lagjja Guerrile – kemi 4 vite që kërkojmë një rrugë prej 150 metrash dhe kemi nevojë për kanalin e ujrave të zeza KUZ sepse jemi të gjithë me gropa septike dhe nuk mund të vijohet kështu. A do të shtrohet kjo rrugë brenda ketij viti ?

Zv. kryetari – është marre si prioritet dhe do të shikohet mundësia për ta futur në buxhetin e vitit që vjen.

Myzafer Vorfa, banor lagjja Ahmet Haxhija - Rrugica ku banojmë në Dudas, Rruga Smakej, është zonë e banuar historikisht dhe është vendosur vetëm ndriçimi dhe nuk ka asnjë investim me asfalt për këtë rrugë. Kemi problem gropat septike sepse nuk ka rrjet të KUZ dhe KUB. Shohim rrugë të kryera në të gjithë Shkodrën dhe nëq është e mundur të investohet edhe kjo rrugë ku banojnë rreth 20 shtëpi.

Banore - tek lagja Partizani është një rrugë 70 metra e gjatë dhe s'kemi as kanalizim KUZ as KUB as ndricim. Të gjitha ujërat e rrugës kryesore që janë përfunduar na krijojnë pastaj edhe problem në këtë rrugicë. Prioritare kemi rrjetin e kanalizimeve.

Zv. kryetari – ka qënë edhe vitin e kaluar e propozuar si rrugë dhe shpresojmë që për vitin tjetër të kemi mundësinë që të realizojmë një investim total edhe në këtë rrugë, rruga ka projektin e zbatimit të bërë.

Luan Zmijani, Lagjja Partizani – kërkesa është në lidhje me një rrugicë prej 50 metrash nuk është bërë asnjë investim në këtë rrugicë dhe është e nevojshme (për tu verifikuar vendodhja e rrugës). A është e mundur që kjo rrugë me emërtimin rruga e Postribes të rishikohet emërtimi i saj. Jane 8 futbollista që kanë lindur në këtë rrugicë dhe duhet të shikohet mundësia për të rishikuar emërtimin e kësaj rruge.

Fusha e lekurave, e njëjta që sa i përket emërtimit “Reshit Rusi“ mendoj që duhet të rishikohet emërtimi i kësaj rruge me emrin e një personazhi sportist ose futbollist nga Shkodra. P.sh: Figura të njohura si Zan Rragami, Din Zhega etj.

Zv. kryetari - Do të shohim me prioritet realizimin e investimit në këtë rrugë që propozoni. Sa i përket ndërrimit të emërtimeve të rrugëve është një diskutim më i gjërë dhe do të vijojmë ta diskutojmë për të gjetur formën e realizimit sipas konsultimit me të gjithë.

Omar Myrtja, inspektor lagjja nr. 2 - Gjatë verifikimit në terren kemi konstatuar problematika në rruget:

1. Blloku Bujar Bishanaku – numër popullsie shumë të lartë
2. Blloku i pallateve tek rruga Martin Camaj, pranë postës Rus

Zv. kryetari – Këto rrugë janë miratuar me rialokimin e fundit të Këshillit bashkiak, po ashtu edhe rrugët:

1. Rruga e mëndafshit
2. Rruga Lek Dukagjini qe është rrugë e rëndësishme me shumë trafik dhe lëvizshmëri
3. Rruga Hashim Kopliku
4. Rruga Komanej
5. Rruga Bisht Iqindi
6. Taip Shkodra
7. Rr. Adem Haxhija
8. Rr. Kushtrimi

Jona Leqejza – U diskutua zona e Dudasit, mendoj që duhet një zgjidhje më afatgjatë por mendoj që edhe duhet filluar nga një kërkesë ndoshta e banorëve sidomos për sheshin pranë stadiumit, i cili tashmë është shkatërruar nga ana e autobuzëve që kalojnë dhe amortizojnë të gjithë sheshin. Përtej problematikës si banorë mendoj edhe si këshilltare që një zonë që është për rekreacion dhe sport të bëhet parkim për autobuzët është e papranueshme dhe jam dakort që nëse vendoset që të jetë parking të paktën të vjelën të ardhura nga shfrytëzimi hapsirës publike për parkim. Të gjitha hapësirat rrotull stadiumit janë të pashfrytëzuara dhe duhet të kenë një administrim për këtë. Kemi propozuar si këshill dhënien në përdorim të këtyre hapsirave sipas VKM nr.54 sepse kjo do ti jepte edhe zonës shumë zhvillim.

Zv. kryetari – amortizimi i zonës së stadiumit vjen nga kalimi i kamionëve dhe autobuzëve. Në kemi marrë angazhim për mirëmbajtje të kësaj zone rreth stadiumit dhe shumë shpejt do të bëhet rehabilitimi i sheshit me anë të mirëmbajtjes.

Jona Leqejza – nqs nuk zgjidhet parkimi dhe kalimi i autobuzëve është e kotë të bëhet investim në këtë zonë.

Zv. kryetari – vjet kemi lidhur kontratat me shoqatat e sportit të cilët kanë marrë në përdorim ambjentet rreth stadiumit. Jemi në pritje nga ana e tyre që t'i vendosin në funksion këto ambjente sipas propozimeve të tyre për të rikonstruktuar.

Andi Halluni - Rruga Lek Dukagjini ka nevojë prioritare për tu rikualifikuar. Një tjetër propozim është heqja e kangjellave dhe rrethimit të teatrit. Po ashtu ka nevojë për ndërhyrje:

1. Rruga Xhelal Mehmet Fishta pas poqerisë, 200 metra me 20 – 30 familje (pranë fushës stërvitore të vllaznisë).
2. Rruga e Golemit (me dalje ne unaze).
3. Sistemim dhe rregullim sheshi i pallateve të Hallunëve në fund të rusit

Një tjetër problematike është zënia e trotuareve nga tre biznese në fund të Rusit që janë problem për kalimtarët nga zënia e trotuarëve. Mirëkuptoj ambulantet por për sa i përket bizneseve qe kanë dyqane dhe zënë të gjithë trotuarin është e pakuptimtë. Dhe duhet të monitorohet edhe nga Rajoni dhe inspektorët.

Zv. kryetari – sa i përket rrugëve do të shikohet sipas prioriteteve. Për teatrin do të bëhet tani një rikualifikim i ambjenteve të jashtme të zonës ndriçim dhe rikualifikim sheshi.

Për hapsirën publike e kuptoj problematikën, që shtroni dhe duhet të ndërhyjmë me verifikim, gjoba e masa.

Elson Celiku – Shqetësim në lidhje me Rrugën Europa nuk e dimë se çfarë vizioni ka bashkia për këtë rrugë, si do të trajtohet a ka një vision konkret apo një qasje më ndryshe për këtë rrugë.

Si drejtues të rinj duhet të ketë një vision ndryshe për rikualifikimin e kësaj rruge që është edhe pasqyra e Shkodrës, për hyrjen e të gjithë turistëve që vijnë nga Hani i Hotit. E sygjeroj fortësisht që të ketë një vëmendje të shtuar.

Zv. kryetari - Kemi diskutuar për rikualifikimin e rrugëve dhe akseve kryesore ku kemi fluks të lartë të turistëve dhe vizitorëve. Jemi fokusuar në tre akse hyrëse të qytetit ku me buxhetin e ri duam të japim vëmendje të shtuar sa i përket rikualifikimit sidomos të fasadave, gjelbërimit dhe ndriçimit. Është fakt i diskutuar dhe shpresojmë të konkludojmë me një projekt konkret.

Andi Halluni – kur flasim për rrugën Europa duhet të merret parasysh segmenti nga rreth rrotullimi tek shkolla e muzikes deri në dalje të qytetit. Të mendohet mundësia e kthimit në një zonë pedonale. Gjithashtu edhe dekorit urban t'i jepet një vëmendje në këto rrugë në kuadër të festave të fundvitit.

4. Kujdesi shendetsor – qendra shendetsore

Erjon Metushi – qendra shendetsore nr. 3 në lagjen nr. 2, lagjet e qyteti dhe qendrat shendetsore duhet të verifikohen konkretisht. Kjo është qendër me shumë fluks dhe frekuentim si rezultat i numrit të banorëve. Duhet të verifikohen në vend sepse hapesirat janë të pamjaftueshme me kushte jo të mira duke krijuar problem për stafin e sidomos për pacientët.

Duhet të kemi një grup pune me të cilin të behët një analizë konkrete të këtyre qendrave si në lagje të qytetit por edhe në pjesë të tjera.

Kemi filluar një proces identifikimit dhe analizimi dhe shpejt do t'ju e vendosim në dispozicion këtë material për të parë ndërhyrjet që duhet të realizohen.

Zv. kryetari – jam dakort sa i përket këtij propozimi për krijimin e një grupi pune edhe me drejtorinë tonë për të bërë identifikim dhe analizim konkret për të gjitha problematikat.

Zv. Kryetari i Bashkisë :

Duke ju falenderuar për opinionet dhe nevojat e paraqitura ju falenderoj sërish dhe shpresojmë që të kemi mundësinë të realizojmë këto propozime të bera sot këtu nga ana juaj.

Pyetje dhe diskutime të tjera nuk ka. Mbledhja deklarohet e mbyllur.

Mbajtësi i Procesverbalit:

Bekim Mema





BASHKIA
SHKODËR

Këshillim me publikun -Për draftin e projektplanit buxhetor afatmesëm 2023-2025.
Lagja nr.2

NR	EMER	MBIEMER	GJINIA	MOSHA	VENDBANIMI	PROFESIONI	PUNESIMI
1	Andri Hollari		M	48	Shkoder	Jurist	Privet
2	Alban Jani		M	50	SHKODËR	PEFAQESUES	SHKODËR TËNÇI
3	Dyren Zmijani		M	42	SHKODËR	SIPKËNIMTAR	Privet
4	Luan Zmijani		M	46	Shkoder	Trainer	
5	Gloria Shllaku		F	32	11-11	Mësuese	Zhvendri shqipërisë
6	Mesurina Gencari		F	38	Shkoder	Ekonomiste	B. Shkoder
7	Dylam Lesha		M	68	Shkoder	Elektricitet	Vendbanist
8	Emar Murgu		M	28	Shkoder	Inspektor	B. Shkoder
9	Gent Shaya		M	28	Shkoder	Inspektor	U-K-SH
10	Alfred Lulati		M	56	Shkoder	Jurist	Bektesh Shkoder
11	Jon Maleshi		F	44	Shkoder	Jurist	B. Shkoder
12	Erion Durraku		M	30	Shkoder	Jurist	B. Shkoder
13	Ali Bajgati		M	72	SHKODËR	Pancionist	Pancionist

COORDINATORI PER KONSULTIMIN PUBLIK

[Handwritten signatures and notes]

